



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E
MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE**

**TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:
KUALIFIKIMI PROFESIONAL “SILVIKULTURË”**

(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)

Tiranë, 2024

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të për Kualifikimin Profesional “**Silvikulturë**” me strukturë 2+2 (klasa e 12, dhe 13-të), për provimin e detyruar “**Teori profesionale e integruar**” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testimeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “**Pyje**”, Niveli II i KSHK-së (klasa e 10-të dhe 11-të);
- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “**Silvikulturë**”, Niveli IV i KSHK-së (klasa e 12 dhe 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja si dhe analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “Teorisë profesionale të integruar”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënëit dhe arritjeve si dhe përzgjedhjen e nxënësve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar “**Teori profesionale e integruar**” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional “**Silvikulturë**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë

hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth 30% të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale. Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të nxënësve.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit e detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “**Silvikulturë**“, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Fidanishte kl. 10-të.
2. Silvikultura kl. 11-të dhe 12-të
3. Mbarështim Pyjesh kl. 12 dhe 13-të.
4. Pyllëzime artificiale kl. 13.

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Fidanishte	47	20
2	Silvikultura	68	30
3	Mbarështim pyjesh	88	39
4	Pyllëzime Artificiale	27	11
	TOTALI	230	100%

Temat sipas lëndëve janë:

a) Fidanishte kl. 10-të.

(47 orë)

- Pylli si burim i prodhimit të lëndës së drurit. 2 orë
- Klasifikimi dhe zgjedhja e drurëve. 4 orë
- Klasifikimi dhe zgjedhja e grumbujve farorë. 6 orë
- Treguesit cilësorë e sasiorë të farërave. 6 orë
- Veçoritë e mbjellës së farërave. 2 orë

• Veçoritë e përgjithshme të fidanishteve pyjore.	3 orë
• Kriteret dhe procedurat e mbjelljes së farërave në fidanishte.	20 orë
• Prodhimi i fidanëve me kalem.	2 orë
• Standardet e prodhimit të fidanëve.	2 orë
b) “Silvikultura”, kl. 11-të dhe 12-të:	(68 orë)
• Njohuri të përgjithshme mbi pyllin.	4 orë
• Drunishtja, karakteristikat e saj.	10 orë
• Nëndrunishtja filizeria dhe shtresa barishtore.	3 orë
• Raportet ndërmjet pyllit dhe faktorit klimatik.	8 orë
• Raportet ndërmjet pyllit dhe faktorit tokësor.	4 orë
• Raportet ndërmjet pyllit, faktorit të relievit dhe faktorit biotik.	4 orë
• Ripërtëritja, rritja dhe zhvillimi i pyllit.	5 orë
• Kujdesi për grumbujt pyjor dhe drejtimi i tyre.	8 orë
• Organizimi dhe planifikimi i prerjeve kulturele.	6 orë
• Trajtimi i pyjeve trungjishte.	6 orë
• Trajtimi i pyjeve cungjishte.	5 orë
• Trajtimi i pyjeve cungjishte të përbëra.	5 orë
c) “Mbarështim pyjesh dhe kullotash”, kl. 12 dhe 13-të:	(88 orë)
• Njohuri të përgjithshme për mbarështimin e pyjeve.	5 orë
• Elementët tekniko – ekonomik të mbarështimit të pyjeve.	5 orë
• Format e metodat e përcaktimit të shfrytëzueshmërisë.	7 orë
• Njohuri të përgjithshme për fondin e prodhimit.	8 orë
• Njohuri të përgjithshme për ciklin e prodhimit.	5 orë
• Regjimi dhe trajtimi.	4 orë
• Mbarështimi i trungjishteve të rregullta.	9 orë
• Mbarështimi i trungjishteve kopshtore.	4 orë
• Mbarështimi i cungjishteve.	3 orë
• Studimi dhe përshkrimi i kushteve natyrore të prodhimit.	3 orë
• Metodat e matjes së grumbujve pyjorë.	5 orë
• Teknika e mbarështimit të pyjeve.	3 orë
• Zbatimi i planeve të mbarështimit.	2 orë
• Njohuri të përgjithshme për kullotat dhe livadhet.	3 orë
• Bimësia e kullotave.	6 orë
• Klasifikimi i kullotave.	2 orë
• Përmirësimi i kullotave.	8 orë
• Shfrytëzimi i kullotave.	6 orë

d) “Pyllëzime dhe mbrojtje e tokës”, kl 13-të:	(27 orë)
• Njohuritë të përgjithshme për pyllëzimet, zgjedhja e llojeve.	1 orë
• Teknikat e pyllëzimit.	8 orë
• Pyllëzimi me farë, fidanë dhe kalema.	6 orë
• Mirëmbajtja e tokës dhe kulturave.	1 orë
• Pyllëzime në toka të zhveshura të pyllëzuara.	3 orë
• Zbatime, pyllëzime në raste të veçanta.	2 orë
• Brezat mbrojtës.	2 orë
• Mbjellja gjatë rrugëve.	2 orë
• Zonat e gjelbra urbane dhe mikrobaset.	2 orë